



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1746 prot.

Pukë, më 02.10.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. 10 datë 07.10.2025

PËR

DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I BASHKISË PUKË

Z. FAHRI BUKUROSHI

(Pas vdekjes)

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë _____.10.2025;

Vendosi:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. FAHRI BUKUROSHI

(Pas vdekjes)

Me motivacionin:

Në nderim të kontributit të tij si mësues dhe drejtues shkolle për shumë vite, i cili me përkushtim e profesionalizëm formoi breza të tërë nxënësish dhe mësuesish. Një figurë frymëzuese në arsimin vendas, model i dijes dhe urtësisë, që la pas një trashëgimi të çmuar arsimore dhe qytetare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Pukë.

Paraqiten projektin;

Drejtori i Menaxhimit të BNJ.

Sokol Gjoni

Juristi

Aida Sinani

Kryetari

Rrok Dodaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1748/prot.

Pukë, më 07.10.2025

RELACION
Mbi
PROJEKT VENDIMIN
Nr. 10, datë 07.10.2025

PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' I BASHKISË PUKË

Z. FAHRI BUKUROSHI

(Pas vdekjes)

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa "m"; ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, sjellim për miratim këtë projektvendim, i cili është vijimësi e vlerësimit të disa figurave që kanë lënë gjurmë me rolin dhe kontributin e tyre, duke i shërbyer atdheut dhe kombit në rrugën e tij drejt zhvillimit dhe prosperitetit.

Emri i z.Fahri Bukuroshi, i propozuar nga Shoqata Kulturore e Mësuesve të Pukës në Tiranë për dhënie të titullit "Qytetar Nderi" (Pas vdekjes) i Bashkisë Pukë, pasi ka kaluar Komisionin Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, paraqitet sot për këtë vlerësim, duke çmuar rolin e tij si mësues e drejtues shkollë prej vitesh, duke dhënë një kontribut të madh në përgatitjen cilësore të brezave, metodist dhe mësimdhënës frymëzues për gjenerata të shumta arsimtarësh.

Nisur nga rol, i faktuar përmes veprave konkrete, ju ftoj t'a votoni këtë projekt-vendim!

Bashkëlidhur:

1. PROJEKT VENDIMI, Nr. 10, datë 07.10.2025


PËR DHËNIEN E TITULLIT 'QYTETAR NDERI' I BASHKISË PUKË Z. FAHRI BUKUROSHI, (PAS VDEKJES)

- Dokumentacioni njohës mbi jetën dhe veprën e tij.
- Miratimi i Komisionit Këshillimor.

Drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Sokol Gjoni

Selcuk Spas
Hazbi' ierfuar
per pjetet
08.04.24
F. HAZBI



SHOQATA KULTURORE E MËSUESVE TË PUKËS NË TIRANË

Lënda: Kërkesë për dhënien e titullit "Qytetare Nderi" i Bashkisë Pukë Z.
FAHRI HAZBI BUKUROSHI (pas vdekjes)

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak, në kuadrin e vlerësimit të njerëzve që I kanë shërbyer arsimit dhe kulturës në Rrethin e Pukës, ju propozojmë për dhënien e Titullit QYTETAR NDERI I BASHKISË Pukë Z. FAHRI HAZBI BUKUROSHI (pas vdekjes)

Përshkrimi i jetës dhe veprimtarisë së Mësuesit dhe Drejtuesit,
Fahri Hazbi Bukuroshi

Lindi më 08.06.1953 ne fshatin Qerret te rrethit te Pukes. Arsimin 8-vjecar e mbaroj me shkollen "Ali Bytyqi", Qerret ne vitin 1968 me rezultate te shkelqyera. Arsimin e mesem te pergjithshem e kryen ne shkollen e mesme "Migjeni" ne Puke ne vitin 1972, Arsimin e larte e mbaroi ne Institutin e Larte Pedagogjik , sot Universiteti "Luigj Gurakuqi" ne Shkoder, ne vitin 1975 dhe pas 1 viti stas, ne vitin 1976 diplomohet me rezultate te larta per te gjithe ciklin e studimeve, me titullin: Mesues I Biologjise dhe Kimise. Ne vitin 1975 emerohet mesues stazhier ne shkollen 8 vjecare Dush, detyre te ciles e kryen si mesues per 16 vjet po ne kete shkolle. Ne vitin 1991 emerohet drejtor ne shkollen 8 vjecare Qerret. Nga viti 1995 - 1998 punoj si mesues ne dispozicion te Drejtorise Arsimore te qytetit te Tiranes. Nga viti 1998 - 2000 punoj mesues I Medreses Tirane, pastaj mesues ne shkollen "Fan Noli" e '1 Maj' deri ne vitin 2018, kur u nda papritur nga jeta.

U lind dhe u rrit ne nje familje te nderuar dhe respektuar Qerretase me edukaten e prinderve qe e donin shkollen dhe arsimin. U martua ne vitin 1976 me Hasimen, nje vajze qe rrjedh nga nje familje shume e larte ne Tropoje. Ajo kishte mbaruar petagogjiken me rezultate shume te larta dhe ishte nga mesueset me te mira te rrethit. Te dy bashke u bene bashkeudhetar te shquar ne rrugen e asimit pukjan. Familja e tyre u shtua me dy vajza dhe nje djale qe i rriten dhe edukuan me edukate dhe perkushtim. Familja e tij e madhe dhe e vogel ka gezuar dhe gezon respekte nga komuniteti I Qerretit, Pukes e Tiranes dhe kush I njeh ata. Mesuesit dhe koleget e Fahriut, kur ishte nxenes ne Gjimnazin e Pukes, shprehen me respekte dhe vleresime shume te larta si ish nxenes shume I mire ne mesime, I sjellshem, korrekt dhe shume I respektueshem. Ne shkollen e larte u dallua si student kerkues ndaj vehtes dhe me synime per te dale me rezultate te larta.

Kete objektiv e arriti me se miri, sepse u rendit ne radhen e studenteve me te mire te kursit. E filloj pune ne shkollen 8 vjecare Dush ku per 16 vjet, per nevoja kuadri, pervec mesimit, bente dhe 3 ore rruge ne kembe dhe kur nuk u lodh e kurre nuk u ankua. Shoku I tij bashkestudent, e me vone shef I seksionit te Arsimit te Pukes, Preng Pristja kujton: 'Si nuk me tha qofte edhe nje here Fahriu qe ta afroje ne nje shkolle tjeter. Madje ai eshte shprehur keshtu: S'ka problem se lodhem, jam I ri dhe duhet e kontriboj per kete fshat qe nuk ka asnje mesues vendas'. Ai shprehte falenderimet qe ne I benim punes se tij.

Jane shume te pakte njerez te tille qe bejne sakrifica ne interest e arsimit sic bente Fahriu.

Ai qysh ne ditet e para, e filloj punen me shume pasion e vullnet. E gjeti shkollen e Dushi pa asnje mjet mesimor. Brenda vitit te pare ai arriti te ndertoje kabinetin e biologjise dhe te kimise, duke u bere keshtu shembull per mire ne te gjitha zonen e qendres se Pukes.

Metodika e mesimdhenjes dhe komunikimi shume I ngrohte me nxenesit, eksperimentet shkencore qe bente ne klasen e kabinet qe kishte ngritur vete, dhe cilesia e mire e pervesimit te njohurive nga nxenesit, e renditen kete mesues ne radhen e me te mireve te rrethit.

Keto ishin konkluzionet e deklaruar me shkrim ng ate gjitha kontrollet e pervitshme te Seksionit te Arsimit e te drejtorise se shkolles per kete mesues.

Fahriu, duke u perzgjedhur si njeri nga me te miret e rrethit, ka marre pjese disa here si anetar I ekipeve te kontrolli re Seksionit re Arsimit. Konkluzionet e kontrolleve te tij ishin shume te sakta nga ana shkencore e metodike, por shume korrekte.

Pervoja e tij si mesues eshte pergjiithsuar disa here ne shkalle rrethi nga Seksioni I Arsimit. Ai ka qene I zgjedhur edhe ne detyren e kryetarit te komisionit te lendeve te biologji - kimi oer zonen qe qendres, detyre qe e ka kryer shume mire.

Ne aksionin kombetar per ngritjen e kabineteve te kimise ne vitin 1986, prej punes se tij kabineti I shkolles Dush eshte vleresuar si nder me te miret e rrethit.

Ne ekspoziten e mjeteve mesimore qe ndertonin mesuesit me duart e tyre qe u hap ne mjediset e Pallatit te Kultures te Pukes, punimet qe solli Fahriu u vleresuan nga me te mirat e rrethit.

Ne nje prononcim qe eshte bere per punen e Fahriut ne rrjetet sociale me rastin e 7 vjetorit te ndarjes nga jeta te tij jane shprehur me shume konsiderata e vleresime mbi 200 ish nxenes, mesues, koleg, miq e drejtues arsimi e institucionesh te tjera per punen e Fahriut.

Ne vitin 1987, me propozim te Seksionit te Arsimit, Ministria e Arsimit e ka vleresuar me Certifikaten "MESUES I DALLUAR".

Per keto vleresime dhe cilesi te larta te personalitetit te tij, Fahriu ne vitin 1991 u emerua ne postin e drejtorit te shkolle 8 vjecare Qerret ku punoj ne kete pozicion deri ne vitin 1995, ku u dallua ne te gjitha aspektet si drejtues shume I mire, organizator, korrekt dhe shume I komunikueshem me mesuesit, nxenesit e prinderit.

Edhe ne Tirane ka punuar po me kete ndjenje pergjegjesie si ne Puke.

Ne komunikimin qe kemi pasur me drejtuesit e shkollave te Tiranes e koleg te Fahriut, kemi marre kete vleresim:

Fahriu me punen e tij na ka nderuar shkollen tone dhe rrethin e Pukes.

Per keto cilesi e shume te tjera, Shoqata Kulturore e Mesuesve te Pukes ne Tirane, me propozim tw disa prej kolegwve tw tij kane vendosur qe ti propozojne Keshillit te Bashkise se Pukes qe z. Fahri Bukuroshi te nderohet me titullin Qytetar Nderi pas vdekjes, duke qene te bindur qe e meriton plotesisht.

Motivacioni.I jepet tituli Qytetar Nderi I Bashkse Puke zotit Fahri Bukuroshi pas vdekjes

(08.06.1953 – 04.03.2018)

Me kete motivacion:

Si mesues e drejtues shkolle qe punoi gjate gjithë jetes se tij me perkushtimin me te madh per ngritjen cilesore te mesimdhenjes dhe mesimnxenjes pre nxenesve, duke u bere njeri nder mesuesit e drejtuesit me te mire e me rezultativ ne rrethin e Pukes.

Në pritje të miratimit të kërkesës sonë ,

Propozuesit:

- | | |
|--------------------|------------|
| 1-Zamira Matoshi | H46122090Q |
| 2- Preng Pistja | F11010047E |
| 3- Luigj Deda | E20329051T |
| 4- Fadil Coba | F10605041Q |
| 5- Ismet Bala | D70505098E |
| 6- Muharrem Neziri | D80527024A |
| 7- Nikoll Nika | E00101443T |
| 8- Pashk Leka | E811200860 |
| 9- Fran Cara | F10605061H |
| 10- Isa Islami | F40429025N |

Kryetare e Shoqatës Kulturore së Mësuesve të Pukës në Tiranë

